



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Prishtinës**  
Opština Prishtina – Municipality of Prishtina

## **E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**

të mbledhjes së parë të Komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara,  
mbajtur më 16.01.2020, e cila filloi në orën 13:30.

Në mbledhje morën pjesë: Fatime Demolli – Mustafa, kryesuese, anëtarët e komitetit:  
Ramadan Salihu, Gyltene Retkoceri dhe Ermira Shabani.

Munguan: Mehreme Llumnica, Jeton Tanhasi dhe Armend Ademi.

E pranishme ishte edhe: Premtime Preniqi, koordinatore e Njesisë për të drejtat e njeriut.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese me këtë

### **REND DITE :**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara;
2. Miratimi i Raportit mbi punën e Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara në Komunën e Prishtinës për vitin 2019;
3. Punësimi i profesionistëve në institucionet arsimore dhe personave me aftësi të kufizuara;
4. Plani i punës së Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara për vitin 2020;
5. Rekomandime ;
6. Të ndryshme.

U konstatua se njëzëri u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara.

**Pika e dytë**

**Miratimi i Raportit mbi punën e Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara në Komunën e Prishtinës për vitin 2019**

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese** tha se sa i përket Raportit mbi punën e Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara, në Komunën e Prishtinës për vitin 2019 zotëri Ramadani e ka bërë një përmbledhje për punën e KKPAK-ra ku e falënderojmë për kontributin e dhënë.

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratuan Raportit mbi punën e Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara në Komunën e Prishtinës për vitin 2019.

**Pika e tretë**

**Punësimi i profesionistëve në institucionet arsimore dhe personave me aftësi të kufizuara**

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese** tha sa i përket punësimit të profesionistëve si komitet e kemi ngritur mjaft këtë çështje, mirëpo ndoshta duhet me bërë më tepër duke pas parasysh që Ministria e Arsimit ka ndarë buxhetin për punësimin e 12 asistentëve për fëmijë me nevoja të veçanta qysh para dy viteve dhe Komuna e Prishtinës ende nuk e ka hapur konkursin e cila është dashur me qenë shembull për komunat e tjera. Në gjithë Kosovën thuaje gjitha komunat 80% kanë hap këto vende të punës, ku Ministria e Arsimit e ka paraparë që për 5 vitet e ardhshme me i punësuar 500 asistent për fëmijë me nevoja të veçanta.

Sa i përket profesionistëve të tjerë si logopedëve, psikologëve, pedagogëve, mësueseve mbështetës ato janë të rregulluara me normativën e punës dhe janë të rregulluara me numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta të cilat ndodhen në institucionet. Ne në këtë pjesë e kemi ma vështirë me ndërhy, ndërsa më lehtë për punësimin e asistentëve, se është i ndarë buxheti.

**Gyltene Retkoceri** tha se pajtohem me kryesuesen se është për me të ardhur keq se Prishtina është kryeqytet dhe me qenë shembull për komunat tjera ku ato veç i kanë pranuar dhe e kanë stafin e asistentëve e Komuna e Prishtinës ende nuk ka asgjë. Kërkoji të dijë se cila është arsyeja, pse nuk marrin asistent.

**Ermira Shabani** tha se në takimin që kishim me drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit, ajo na informoi se ka qenë një gabim në linjat buxhetore në Komunë. Sipas mendimit tim ne duhet nga DKA me kërkuar që ata me shty procesin përpara, nëse problematika nuk qëndron te DKA, atëherë me ju drejtuar burimeve njerëzore nëse nuk është as te burimet njerëzore, duhet drejtuar Ministrisë së Arsimit.

UÇK- 2-10.000  
Prishtinë-Kosovë

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese** tha se nuk është problemi te Ministria e Arsimit se Ministria e Arsimit e ka paraparë buxhetin për pesë vjet për asistentë.

**Gyltene Retkoceri** tha se drejtoresha e arsimit vetëm na është përgjigjur se ka qenë një gabim dhe do të punësohen ata asistentë, mirëpo ajo nuk e ka marrë parasysh këtë çështje po ashtu edhe për psikolog.

Çështje tjetër që po më intereson është trajnimi i mësimdhënësve rreth aftësive të kufizuara arsimore se ne nivelin e njohjes së punës rreth këtyre fëmijëve e kemi në një shkallë shumë të ulët, pra kjo është një çështje që Komuna e Prishtinës mundet me e rregulluar.

**Ermira Shabani** tha se kjo është një problematikë shumë e madhe, prej vitit 2017 që punoj unë në Down Sindrom Kosova ne jemi duke organizuar trajnime kryesisht për mësimdhënës. Mendoj se thelbi kryesor i problematikës qëndron te monitorimi se nuk ka monitorim të mirëfilltë po të kishte gjërat kishin qenë ma ndryshe.

**Premtime Preniqi** propozoi që, çdo herë mbas takimeve që i mbani, kërkesat e juaja ti adresoni përmes e-mail adresës, me qëllim që të njoftohen sa më shumë njerëz, të cilët janë kompetent për këtë çështje, si dhe të kërkohet një afat kohor, pasi që koha ka një rëndësi shumë të madhe.

**Gyltene Retkoceri** tha se në takimin e kaluar me drejtoreshën e arsimit në këto dy pika edhe për asistent edhe për psikologët na është thënë se për asistent është gabimi që është bërë, ndërsa për psikologët kjo nuk varet prej meje, varet prej burimeve njerëzore kur ata si i kanë planet buxhetore.

**Ermira Shabani** pyeti se a ekziston një analizë e situatës të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Komunën e Prishtinës. Sikur të ish bërë një analizë që e kishte pasqyruar çështjen si qëndron situata, atëherë ne e kishim pasur shumë më lehtë me thënë se në "x" shkollat janë kaç fëmijë me aftësi të kufizuara por staf profesional nuk ka.

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese** tha se lidhur me këtë çështje, është ekipi vlerësues komunal i cili del në teren dhe në bazë të kërkesave të prindërve dhe drejtorive të institucioneve arsimore, dalin i vlerësojnë fëmijët, e dinë sa fëmijë janë nëpër shkolla, kopshte me nevoja të veçanta. Për veç ekipit neve Komuna na kërkon të dhëna për të gjithë fëmijët e institucioneve dhe jemi të obliguar me lajmëruar sa fëmijë i kemi me të gjitha llojet e diagnozave d.m.th çdo vit e ka Komuna analizën e secilit institucional, sa fëmijë me çfarë probleme ka.

**Premtime Preniqi** tha se ne e kemi performancën komunale që e bëjmë dhe të gjitha të dhënat i japim në performancë.

**Ermira Shabani** tha se a mundemi ne me pas një informacion si p.sh një informacion sa i përket kopshtit "Botanika".

**Premtime Preniqi** tha se Drejtoria e Arsimit nuk kanë të dhëna për bazë në komunitet.

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese** tha se sa i përket punësimit, DKA nuk ka kompetenca për punësimin e stafit, për punësim përgjegjësia komplet është te burimet njerëzore.

**Premtime Preniqi** tha se te punësimi tani është një ndryshim i ligjit, ku tani për mi punësua as Komuna nuk ka me pas mundësi mi punësua, se ka mu bërë një zyrë e veçantë në Ministri dhe aty kanë mu u kryer ë gjitha procedurat për punësim.

**Ramadan Fazliu** tha se këtu janë dy aspekte të punësimit të këtyre njerëzve, psikologët janë punësim i përgjithshëm, nuk kanë të bëjnë me komitetin ndërsa logoped, pedagog special, mësuesit mbështetës etj këta kanë punë pikërisht me neve.

Lidhur me punësimet për këtë kategori, ne mundemi mi dhënë rekomandimet, mirëpo këtu është hendikep se ne quhemi këshill dhënës dhe pesha jonë është e vogël. Duhet ta sqarojmë se kush është një autoritet që neve na njeh, që rekomandimet tona me pas adresë. Ne duhet me u lidh me dikën që ai na njeh, se drejtori jonë që ka lidhje drejtpërdrejt me neve ai e ndan përafërsisht këtë mendimin që po them që kur të kemi ndonjë çështje si çështja e kopshtit mi shkuar kërkesa edhe e drejtorit. Po ashtu kërkoj raport se çka ndodhi me vizitën që e bënë KKPAK, se nuk patëm përgjigje qe tri vite që kemi qenë në secilën drejtori të komunës, ku vetëm "Trafiku Urban" na është përgjigj rekomandimeve tona, andaj ne duhet ta sqarojmë rolin tonë te ata që na kanë zgjedh, qoftë administrata qoftë ndonjëri nënkryetar dikush që merret me operativë e jo me politikë.

**Premtime Preniqi** tha se ligji është, rregulloret e parashohin vetëm dy komitete obligative e tjerat janë jo obligative. Komiteti është këshillëdhënës dhe ju duhet rekomandimet që i bëni mos mi lënë në heshtje, pra përveç që i caktoni afat kohor asaj drejtorie, duhet faktikisht edhe me ja përsëritë edhe me e-mail.

**Ramadan Fazliu** tha se edhe nëse është rregullorja unë do të kërkoj nga ata njerëz që na kanë krijuar që ne mu bërë komitet funksional jo konsultativ.

**Gyltene Retkoceri** tha se mendoj prapë duhet mu takuar me drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit dhe me burimet njerëzore.

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese** tha se nuk kemi pse të shkojmë, janë dy organe që neve na kanë dështuar këtë mandat.

**Ramadan Fazliu** tha se mundemi me i njoftuar edhe burimeve njerëzore dhe Drejtorinë e Arsimit se në terren është situata kësi soji me nxënësit me aftësi të kufizuara, prandaj pranimi i këtyre njerëzve si logoped, psikolog, mësues ndihmës është ma së i nevojshme dhe nuk donë kriteret paraprake.

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese** tha se këto dy reagimet që i ka përgatitur kolegu për kopshtin "Botanika" dhe të drejtën për punësim ne mi dërguar te Kryetari dhe dy nënkryetarët dhe nëse brenda javës nuk marrë përgjigje prej asnjërit çka do të bëjmë tutje me ato dy e-maillet që i dërguam.

**Premtime Preniqi** tha se ju si këshillëdhënës, e juaja është t'ia dërgoni e-mailin, e njofton dhe e kërkon një përgjigje se si komiteti çka mundemi me vendos ma tutje për me vazhduar procesin.

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese** tha se po mbetet që dy reagimet me ja dërguar kryetarit, nënkryetarëve, pastaj tek kryetari dhe nënkryetarët një takim siç po thotë zotëri

Ramadani se kush na përfaqëson neve në mënyrë që të kenë parasysh drejtorët e drejtorive për pranimin e sugjerimeve që ne i bëjmë.

**Pika e katërt**

**Plani i punës së Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara për vitin 2020**

**Premtime Preniqi** tha se sa i përket Planit të punës së KKPAK, ju duhet me analizuar dhe secili mi dhënë rekomandimet e veta dhe me ia bashkangjitur planit.

**Ramadan Salihu** tha se ky plan vetëm kur ka nevojë mu plotësua se ai është për gjithë mandatin, vetëm e kontrollojmë dhe vitin ja ndryshojmë prej 2019 në 2020 dhe e votojmë si plan i punës.

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese** tha se po mbetet që në fund të javës të kontrollohet dhe t'iu dërgohet në e-mail të anëtarëve të Komitetit.

**Premtime Preniqi** propozoi si rekomandim që anëtarët e Komitetit me pasur komunikim edhe jashtë takimeve dhe mi paraqitur kërkesat e tyre.

**Pika e pestë**

**Rekomandimet**

Në bazë të diskutimeve, Komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara nxori këto

#### REKOMANDIME:

1. Bashkëpunimi i anëtarëve të Komitetit konsultativ të PAK -ra;
2. Takime me Kryetarin e Komunës dhe dy nënkryetarët;
3. Dy reagimet sa i përket dy institucioneve t'iu dërgohen me e-mail Kryetarit dhe nënkryetarëve dhe të kërkojmë prej tyre për hapa të mëtejshëm;
4. Dërgim e-mali Drejtorisë së Arsimit dhe Burimeve njerëzore se ku është çështja e punësimit të asistentëve për PAK -ra.

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese** tha se sa për informim i kam dërguar dy herë Këshillit për të Drejtat e Njeriut e-mail për takim dhe nuk kam marrë përgjigje prej tyre po pres edhe këtë javë përgjigje nëse jo do ti kontaktoj direkt me telefon dhe me vendos një takim me zotëri Bexhetin të cilin takim e kemi kërkuar.

*Mbledhja përfundoi në orën 14:45.*

**Procesmbajtësja:**  
**Shyhrete Islami**

**Kryesuesja e Komitetit**  
**Fatime Demolli - Mustafa**



Faqe 5 nga 5